



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 29 Prill 2005, mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 19 në Transfer prej Fondit Suplementar të Pensionit dhe të Nenit 24 mbi Transferin e Pensionit Individual Suplementar, të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, ("Rregullorja e Pensionit), Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e tij të mbajtur më 16 Mars 2006, miraton si vijon:

Rregulla 20 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Transferet dhe Pagesat e Transferit të Mjeteve të Pensionit të dates 23 Tetor 2002

Neni 1

Sfera dhe qëllimi i Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet Fondit Suplementar Pundhënës të Pensioneve ("Fondit të Pensioneve") dhe Pensioneve Suplementare Individuale ("Siguruesve të Pensionit") si dhe pjesmarrësve dhe përfituesve të Fondit Pensional dhe Siguruesve të Pensioneve. Kjo rregull gjithashtu i adresohet Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës deri në atë shkallë ku Trusti është fond që pranon transferin.

1.1 Qëllimi i Rregullës

Në pajtueshmëri me Rregulloren e Pensionit, kjo Rregull themelon kërkesat procedurale për transferin e mjeteve të pensionit në ndonjë entitet tjetër të pensionit, dhe mënyrën e pagesës së transfereve të tilla në pajtueshmëri me udhëzimet e pjesmarrësve dhe përfituesve.

Neni 2

Dispozitat e Përgjithshme

2.1 Definimi

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq janë definuar më pas në këtë Rregull.

“Pensioni i shtyer” nënkupton benefitin e pensionit që është i rezervuar për pjesmarrsin kur të përfundon punsimin asaj/atij, para moshës së pensionit, mirpo i cili shtyhet deri në moshën e pensionit.

“Entiteti i pensionit” i referohet Fondit të pensioneve ose Siguruesve të Pensioneve, ose Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, sikur që konteksti saktësisht tregon.

“Përfundimi i marrdhënjes së punës” nënkupton ndërprerjen ose ndarjen e marrdhënjes Pundhënës-I punësuar, në të cilën bazohet pjesmarrja e një individi në Fondin e Pensionit, për qfarëdo shkak tjetër nga pensionimi, kualifikimi i invaliditetit, ose vdekja.

“Të Drejtat e Ligjshme (të rezervuara)” të pjesmarrësit në Pensionin me Kontribut të Definuar është vlera e Mjeteve pensionale në llogarinë individuale të asaj/atij. “Drejtat e Rezervuara” të pjesmarrësit në Pensionin me Benefit të Definuar është vlera e mjeteve të pensionit e përcaktuar në pajtim me dispozitat e Urdhëresave të Pensionit ose Rregullave të Pensionit të aplikuar. Ky determinim është bërë bazuar në metodën ose metodat e llogaritjes të aprovuara nga BPK-ja për përcaktimin e vlerës(ave) prezente të benefitit(ve) të ardhshme. Drejtat e rezervuara nuk mund të konfiskohen ose humben. Sido që të jetë e drejta për të shfrytëzuar dhe pranuar benefitin vjen në shprehje vetëm kur pjesmarrsi arrin moshën e pensionit, pensionimin e hershëm, kualifikimin e invaliditetit ose vdes.

Neni 3

Transferet prej Pensionit Pundhënës Suplementar (Fondi i Pensionit)

3.1 E drejta e pjesmarrësit për të transferuar Benefitin e Pensionit

a) Kriteret në Urdhëresën e Pensionit. Urdhëresa e Pensionit duhet të sigurojë pjesmarrsit të drejtën e transferit të të drejtave të rezervuara në benefitin e pensionit të asaj/atij në rrethanat si vijojnë:

1. Përfundimi i punimit.

2. Likuidimi ose bankrotimi i Pundhënësit.

3. Shuarja dhe likuidimi i Fondit të Pensionit.

4. Ndryshimi në kategorinë profesionale të pjesmarrësit, në rast se Pundhënësi ka themeluar rregullim specifik pensional ose Fond të Pensionit për kategoritë e ndryshme profesionale për të punësuarit e tij.

b. Drejtat e Rezervuara për benefit të pensionit. Vlera e “Drejtave të Rezervuara” për benefitin e pensionit që i referohet në a) më lartë, duhet të jetë sikur që është përshkruar në Urdhëresën e Pensionit dhe përcaktuar në pajtim me Rregullën 17 të këtryre Rregullave.

c. Pensioni i shtyer. Urdhëresa e Pensionit duhet gjithashtu të sigurojë për të drejtën e pjesmarrësit punsimi i të cilit është ndërprerë që ti lejohet atij/asaj të lë të drejtat e tija të rezervuara në Fondin e Pensionit si pension i shtyer. Dispozitat duhet qartë të definojnë termet dhe kushtet e aplikueshme për pensionet e tilla të shtyera. Pjesmarrsi mundet në

pajtim me këtë Rregull, të transferoj në qdo kohë të drejtat e asaj/atij të rezervuara në pension të shtyer

3.2 Procedurat në kryerjen e transfereve të benefiteve të pensioneve

Në mënyrë që të kryhet transferi i mjeteve të pensionit prej Fondit të Pensionit (transferuesi) në Fond tjetër të Pensionit, Sigurues të Pensionit ose në Trust (pranuesi i transferit) duhet të përmbushen kërkesat si në vijim:

a)Regjistrimi ose participimi në Entitetin Pensional “transferee” (që pranon transferin) Qdo Fond Pensional ose Sigurues i Pensionit që sponzoron rregullimin pensional duhet, në Urdhëresat e tyre të Pensionit ose Rregullat e Pensionit, të themelon termet dhe kushtet për regjistrimin ose pjesmarrjen në rregullimin(et) e tyre pensional. Për regjistrimin e pjesmarrësve duhet të zbatohen procedurat si vijojnë:

1.Regjistrimet ose format e pjesmarrjes duhet të jenë në dispozicion në entitetin e pensionit për të gjithë pjesmarrsit e propozuar që ti plotsojnë dhe nënshkruajn.

2.Aprovimi i regjistrimit të propozuar ose pjesmarrjes nga entiteti i pensionit që e pranon transferin, autorizon fillimin e kontributeve të pensioneve.

3.Pranimi në entitetin e pensionit i kontributit të parë të pensionit për llogarinë e individit plotëson pjesmarrjen e asaj/atij në programin e pensionit.

b)Njohtimi. Qdo transfer i mjeteve të pensionit kërkon njohtim paraprak me shkrim të nënshkruar nga pjesmarrsi dhe dërguar edhe te Fondi i Pensionit që bënë transferin.

1.Njohtimi me shkrim duhet të jetë konform me kërkesat si vijojnë:

(i).Entiteti Pensional që pranon transferin duhet ti siguroj pjesmarrsit formularin e njohtimit. Formulari duhet të kërkojë për informata të tilla që kërkohen nga Entiteti i Pensionit që e pranon transferin për të regjistruar pjesmarrsin, përfshirë këtu edhe informatat mbi përfituesin.

(ii)Pjesmarrsi duhet të plotsojë dhe nënshkruaj njohtimin.

(iii)Nënshkrimi i një oficeri të Entitetit Pensional që pranon transferin është dëshmi e pranimit të regjistrimit të propozuar të pjesmarrsit në Entitetin Pensional që pranon transferin.

(iv).Fondi Pensional që bënë transferin pranon njohtimin.

2.Detyra për dërgimin e njohtimit. Pjesmarrësi ka obligim që të njohtojë Fondin e Pensionit që bënë transferin për transferin e mjeteve pensionale të asaj/atij. Njohtimi mundë të dërgohet në qdo kohë:

(i).Pas përfundimit, në rast të përfundimit të punsimit. Me përfundimin e punsimit, drejtat e rezervuara të nëpunësit që ka ndërprerë marrdhënjen e punës duhet të konsiderohet si pension i shtyer deri sa ajo/ai të dërgon njohtimin në konformitet të plotë me këtë Rregull.

(ii).Gjatë likuidimit, bankrotimit ose bankrotimit të lartë, në rastë të likuidimit ose bankrotimit të Pundhënësit. Organet më të larta drejtuese të Pundhënësit kanë detyra fiduciare që të njohtojnë Fondin e Pensionit, dhe Fondi i Pensionit ka detyrë fiduciare të

njohtojë pjesmarrësit, për ndonjë bankrotim të madh të Pundhënësit sa më shpejtë që ato kushte të bëhen të njohura ose kuptohen nga këta trupa ose ndonjë antarë tjetër.

Gjithashtu ,organet më të larta të Punëdhënësit kanë detyrë fiduciare që të njohtojnë Fondin Pensional,dhe Fondi Pensional ka për detyrë që të njohtoj pjesmarrësit,për ndonjë dështim të madh të Punëdhënësit të paguaj Kontributet Pensionale sikur që kërkohet me kontratat e plaikueshme të punësimit ose marrëveshjeve kolektive në pajtueshmëri me dispozitat e Urdhëresës së Pensionit.

(iii).Gjatë shuarjes ose likudimit të Fondit të Pensionit në pajtim me planet e deklaruara nga Menagjeri special ose bordi i drejtorëve i cili, në pajtim me Rregullën 21 të këtyre Rregullave, është ngarkuar me ndërprerjen(shuarjen) e Fondit te Pensionit dhe/ose likuidimin dhe shpërndarjen e mjeteve të pensioneve.

(iv).Në qdo kohë, në rastë të ndryshimit në kategoritë profesionale të pjesmarrsit kur Fondet e veqanta të Pensionit janë siguruar për kategoritë e ndryshme profesionale Brenda të njëjtit Pundhënës.

c).Pagesa e transferit të mjeteve të pensionit. Fondi transferues i Pensionit duhet të bëjë pagesën e transferit të mjeteve të pensionit në konformitet me direktivat si vijojnë:

1.Pagesat e transferit duhet të bëhen drejtë në Entitetin Pensional që pranon transferin sikur që është paraqitur në njohtimin me shkrim të përshkruara në nën-nenin e mëhershëm.

2.Pagesa e transferit duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë prej datës së pranimin të njohtimit nga Fondi i Pensionit transferues.

3.Fondi i Pensionit që transferon duhet, për kryerjen e pagesës së transferit, të njohtojë pjesmarrsin për një transfer të tillë. Entiteti i Pensionit që pranon transferin duhet gjithashtu të njohtohet, në pajtim, nëse ndonjë pjesë e mjeteve pensionale të transferuara është favorizuar me ndonjë taksë ose tjetër ngarkesë fiskale, duke përshkruar natyrën dhe vlerën e ngarkimeve të tilla.

4.Pjesmarrja e të punsuarve që kanë ndërprerë marrdhënjen e punës në Fondin e Pensionit që bënë transferin,ndërprehet në ditën e dhjetë të pranimin të njohtimit me shkrim të asaj/atij nga Fondi pranues i Pensionit, duke siguruar se kërkesat e përshkruara në nenin 2 më lartë kanë qenë në përshtatshmëri.

Neni 4

Transferet e Pensionit Suplementar Individual Siguruesit e Pensionit)

4.1 E drejta e pjesmarrsit për të transferuar Mjetet pensionale

a).Kriteret në Rregullat e Pensionit. Rregullat e Pensionit duhet të sigurojnë për të drejtën e pjesmarrësit që të transferojnë “Drejtat e Rezervuara” të asaj/atij në mjetet e pensionit të asaj/atij në rastet si vijojnë:

1.Me kërkesën e pjesmarrësit.

2.Likuidimin ose bankrotimin e Siguruesit të Pensionit.

3.Shuarja dhe likuidimi i Programit të pensionit.

b).Drejtat e rezervuara për mjetet e pensionit. Vlera e “Drejtave të rezervuara” për mjetet e pensionit referuar në a) më lartë, duhet të jetë sikur që është përshkruar në Rregullat e Pensionit dhe përcaktuar në pajtim me Rregullën 18 të këtyre Rregullave.

c).Pensioni i shtyer. Rregullat e Pensionit gjithashtu duhet të sigurojnë të drejtën e pjesmarrsit për të suspenduar ose përfunduar kontributet për programin e pensionit dhe të i lejohet asaj/atij të lë të drejtat e rezervuara si pension i shtyer. Dispozitat duhet qartë të definojnë termet dhe kushtet të aplikueshme në pensionet e tilla të shtyera. Pjesmarrësi mundet në pajtim me këtë Rregull, të transferoj në qdo kohë të drejtat e tija apo të asaj për pension të shtyer.

4.2 Procedurat në kryerjen e transfereve të Mjeteve të Pensionit

Në mënyrë që të kryhet transferi i mjeteve të pensionit prej Siguruesit të Pensionit që bënë transferin në Entitet tjetër Pensional që pranon transferin duhet të plotsohen kërkesat si vijojnë:

a.Regjistrimi ose pjesmarrja në Entitetin e Pensionit që pranon transferin . Qdo Fond i Pensionit ose Sigurues i Pensionit që sponzoron rregullimet pensionale duhet në Urdhëresat e tij të Pensionit ose në Rregullat e Pensionit , të themeloj termet dhe kushtet për regjistrim ose pjesmarrje në rregullimin(et) e tyre pensional. Që të regjistrohen pjesmarrsit duhet zbatuar procedurat si vijojnë:

1.Regjistrimi ose forma e pjesmarrjes duhet të jenë në dispozicion për të gjithë pjesmarrësit e propozuar që ti plotsojnë dhe nënshkruajnë.

2.Aprovimi i regjistrimit të propozuar ose pjesmarrjes nga Entiteti i Pensionit që pranon transferin autorizon fillimin e kontributeve të pensionit.

3.Pranimi i kontributeve të para të pensionit në Entitetin e Pensionit për llogarinë e një individi përfundon pjesmarrjen e asaj/atij në programin e Pensionit.

b.Njohtimi. Qdo transfer i mjeteve të pensionit kërkon njohtim paraprak me shkrim nga pjesmarrësi dhe dërgim te Siguruesi i Pensionit transferues.

1.Njohtimi me shkrim duhet të jetë konform me kërkesat si vijojnë:

(i)Fondi i Pensionit që pranon transferin ose Siguruesi i Pensionit duhet ti sigurojë pjesmarrësit formën e njohtimit. Formulari duhet të përmbaj kërkesën për informata të tilla që mundë të kërkohen nga Entiteti i Pensionit që pranon transferin për të regjistruar pjesmarrësit.

(ii).Pjesmarrësi duhet të plotësoj dhe nënshkruaj njohtimin.

(iii).Nënshkrimi i një oficeri të Fondit të Pensionit që pranon transferin ose Siguruesi i Pensionit është dëshmi e regjistrimit të pjesmarrësit të propozuar në Fondin e Pensionit që pranon transferin ose Siguruesin e Pensionit.

(iv).Siguruesi i Pensionit që bënë transferin pranon njohtimin.

2.Detyra për të dërguar njohtimin. Pjesmarrësi ka detyrë të njohtojë Siguruesin e Pensionit që bënë transferin për transferin e mjeteve pensionale të asaj/atij. Njohtimi duhet të dërgohet në qdo kohë me kërkesën e pjesmarrësit, dhe:

(i)Gjatë likuidimit, bankrotimit ose bankrotimit të lartë, në rast të likuidimit ose bankrotimit të Siguruesit të Pensionit. Trupat më të lartë të Siguruesit të Pensionit kanë detyrë fiduciare të njohtojnë pjesmarrësin për një bankrotim të lartë të Siguruesit të Pensionit në momentin që kjo të bëhet e njohur ose të kuptohet nga ky trup ose ndonjë prej antarëve.

(ii)Gjatë përfundimit ose likuidimit të programit të pensionit në pajtim me planet e deklaruara nga Menagjeri Special, Pranuesi, ose bordi i drejtorëve i cili në pajtim me Rregullat e aplikueshme Bankare dhe të Sigurimit dhe/ose Rregullën 21 te këtyre Rregullave , është e ngarkuar me përfundimin e programit të pensionit dhe/ose likuidimi dhe distribuimine mjeteve të pensionit.

(iii)Në qdo kohë, në rastë të ndryshimit në kategorinë profesionale të pjesmarrësit kur skema e veçantë e Pensionit sigurohet për kategoritë e ndryshme profesionale nga Siguruesi i Pensionit.

c).Pagesa e transferit të mjeteve të pensionit. Siguruesi i Pensionit që bënë transferin duhet të bëjë pagesën e transferit të mjeteve të pensionit në konformitet me direktivat si vijojnë:

1.Pagesat e transferit duhet të kryhen drejtë përsëdrejti në Fondin e Pensionit që pranon transferin ose te Siguruesi i Pensionit siq është treguar në njohtimin me shkrim në nën-nenin e mëhershëm të kësaj Rregulle.

2.Pagesa e transferit duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë prej datës së njohtimit që është pranuar nga Siguruesi i Pensionit që bënë transferin.

3.Siguruesi i Pensionit që bënë transferin duhet gjatë kryerjes së pagesës së transferit, të njohtojë pjesmarrësin për një transfer të tillë. Entiteti i Pensionit që pranon transferin duhet gjithashtu të jetë i njohtuar, në pajtueshmëri, nëse ndonjë pjesë e mjeteve të transferuara është e favorizuar me ndonjë taksë ose ngarkesë tjetër fiskale, duke sqaruar natyrën dhe vlerën e ngarkesave të tilla.

4.Pjesmarrja e një individi në programin e pensionit të Siguruesit të Pensionit që bënë transferin ndërprehet në ditën e 10 të pranimin të njohtimit me shkrim të asaj/atij nga Siguruesi i Pensionit që bënë transferin, duke siguruar se kërkesat e sqaruara në nenin 2 më lartë janë në përputhje.

Neni 5

Transferimet në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

5.1 E drejta e pjesmarrësit për të zgjedhur Trustin

Pjesmarrësi mundë të zgjedhë Trustin I cili do të jetë fond që pranon transferin për mjetet e pensionit që mbahen në Fondin Pensional ose në Siguruesin e Pensionit.Vetëm pjesmarrësit të cilët ende nuk e kanë arritur moshën 65 vjeqare mundë të zgjedhin Trustin I cili do të jetë fond që pranon transferin.

5.2 Konsolidimi I Llogarive Individuale

Mjetet e pensionit të pjesmarrësve të transferuara në Trust duhet të transferohen në Llogaritë individuale ekzistuese, nëse pjesmarrësit e tillë veq marrin pjesë në Trust. Transferi duhet të raportohet në pasqyrën e ardhshme të rregullt të siguruar nga Trusti. Nëse pjesmarrësi nuk e ka Llogarinë individuale ekzistuese, llogaritë e tilla individuale duhet të krijohen nga Trusti.

5.3 Pagesa e pensioneve nga Trusti

Trusti duhet të ja u bëjë të mundshme pjesmarrësve transferimin e mjeteve të tyre pensionale në Trust me të njejtat kushte, sikurse pagesat e tëra (lum sum), pagesat në faza ose anuitetet.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo rregull si e ndryshuar do të hyj në fuqi më 01 Prill 2006.

Michel Svetchine
Drejtori i përgjithshëm